



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



FONDACIONI  
SHOQËRIA  
E HAPUR  
PËR SHQIPËRINË

# RAPORT

## " MONITORIMI I ZBATIMIT TË LIGJIT PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI, NË KUADËR TË OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE "



*Tiranë, Nëntor 2019*

**Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Të ndihmojmë për njohjen dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti në Shqipëri”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) dhe mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA).**



**Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.**

**Punoi:**

Znj. Elsa Dobjani, Eksperte Ligjore

**Rishikoi:**

Znj. Erida Skëndaj – Drejtoreshë Ekzekutive, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Znj. Ardita Kolmarku – Juriste, Komiteti Shqiptar i Helsinkit

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.**

**Autor:**

**©Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

**Rr.Brigada e VIII-të, Pallati “TeknoProjekt”**

**Shk. 2, Ap. 10, Tirana – Albania**

**Kutia Postare nr. 1752**

**Tel: 04 2233671**

**Cel: 0694075732**

**E-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)**

## **PËRMBAJTJA:**

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
<b>OBJEKTI, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT.....</b>	<b>7</b>
<b>I. MONITORIMI I ECURISË SË MIRATIMIT TË AKTEVE NËNLIGJORE DHE PËRGJEGJËSISË SË INSTITUCIONEVE PËRKATËSE.....</b>	<b>9</b>
<b>II. MONITORIMI I OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE.....</b>	<b>11</b>
<b>2.1. QENDRAT E SHËRBIMIT.....</b>	<b>11</b>
<b>2.2. ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE.....</b>	<b>11</b>
<b>2.3. KLINIKAT E LIGJIT.....</b>	<b>13</b>
<b>2.4. ANKETIMET ME QYTETARËT.....</b>	<b>15</b>
<b>III. GJETJET KYÇE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>18</b>
<b>ANEKS.....</b>	<b>21</b>
<b>- Ligji nr.111/2017, "Për Ndhmën Juridike të garantuar nga Shteti".....</b>	<b>21</b>

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

Ligji nr.111/2017 "Për Ndhmën Juridike të garantuar nga Shteti"- **Ligji nr.111/2017**

Ligji nr.10039, datë 22.02.2008 "Për ndihmën juridike", i shfuqizuar - **Ligji nr.10039/2008**

Ministria e Drejtësisë - **MD**

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas – **DNJF**

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike - **KSHNJ**

Këshilli i Ministrave - **KM**

Organizatat jo-fitimprurëse - **OJF**

Institucionet e Arsimit të Lartë - **IAL**

Vendim i Këshillit të Ministrave - **VKM**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në kuadër të nismës së mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, (OSFA), KShH vlerëson si rëndësishëm hartimin e këtij raporti ku janë pasqyruar disa nga gjetjet dhe përfundimet kryesore të monitorimit të realizuar për funksionimin e skemës së ndihmës juridike falas parësore, në një periudhë nëntë mujore, përkatësisht Dhjetor 2018 – Tetor 2019.

KShH ka hartuar një raport të ngjashëm monitorimi më herët<sup>1</sup>, fokusuar specifikisht në ndihmën juridike falas dytësore. Në vazhden e këtij monitorimi, KShH paraqet këtë raport të dytë ku analizohet me objektivitet dhe profesionalizëm skema e ndihmës juridike parësore falas dhe ecuria e saj e deritanishme, sfidat, pengesat dhe niveli i zbatimit të ligjit nga institucionet përgjegjëse.

KShH vëren se në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë, ligji nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", reformon tërësisht skemën e ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, duke përcaktuar rregulla, procedura dhe mekanizma të rinj në ofrimin dhe garantimin e këtij shërbimi.

Ndihma parësore falas, është faktor kyç lidhur me garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve, sepse ajo mbulon ofrimin e informacionit të domosdoshëm mbi metodat dhe procedurat përkatëse të aksesit paragjyqësor të grupeve vulnerabël. Ndihma parësore ka një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për garantimin e të drejtës për informim të qytetarit për të drejtat e tij lidhur me aksesin në shërbime publike dhe aksesin në institucionet publike, por edhe edukimin e tij me zgjidhjen e çështjeve në mënyra të tjera ndërmjetësimi, para gjyqësore. Kjo zgjidhje për rrjedhojë sjell dhe përfitime të tjera të karakterit publik, si mosdërgimi i çështjeve në gjykatë, duke zvogëluar ngarkesën e tyre, zgjidhja në rrugë administrative me sa më pak kohë e energji, duke e bërë zgjidhjen juridike eficiente, etj.

**KShH beson fort në një sistem ndihme juridike efektiv, të nevojshëm dhe të arritshëm për qytetarët në nevojë, me qëllim që të garantojë në praktikë përmbushjen e të drejtave dhe lirive të tyre. Pavarësisht nga përpjekjet e autoriteteve përgjegjëse dhe në mënyrë të veçantë të Ministrisë së Drejtësisë, KShH vëren se ritmet e zbatimit të ligjit për ndihmën juridike nr.111/2017 janë kryesisht të ngadalta, dhe janë shoqëruar me vonesa në drejtim të hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore. Gjithashtu janë konstatuar mungesa sa i takon alokimit të burimeve të nevojshme nga pikëpamja buxhetore, infrastrukurore dhe njerëzore për të bërë të mundur zbatimin e këtij ligji në praktikë.**

Raporti i monitorimit, **evidenton** se, në mënyrë të moderuar vetëm Qendra e Shërbimeve të Ndihmës Parësore Falas pranë Bashkisë Elbasan ka filluar nga funksionimi.<sup>2</sup> Nga parashikimi i afërt për 4 qendra dhe i largët dhe afatgjatë për 12 qendra në nivel qarku, infrastruktura përgatitore për vënien në funksion të tyre është akoma larg të qenit funksionale dhe eficiente. Sa i përket OJF-ve, ato akoma nuk janë autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, edhe pse tashmë, janë miratuar aktet nënligjore lidhur me rregullat dhe procedurat e autorizimit. Për rrjedhojë, akoma nuk ka filluar dhe skema e financimit nga buxheti i shtetit për OJF-të.

<sup>1</sup> I publikuar në Shkurt 2019, në faqen online të KShH. Link: [http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH\\_Shkurt-2018.pdf](http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf)

<sup>2</sup> Kjo qendër u inaguroa më dt. 16 Tetor 2019. Link: <https://www.osfa.al/ngjarje/inagurohet-qendra-e-ndihmes-paresore-ne-qytetin-e-elbasanit>

Klinikat e ligjit, janë funksionale qysh para hyrjes në fuqi të ligjit të ri për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti nr.111/2017. Disa prej tyre janë vendosur pranë universiteteve. Klinikat nuk janë mbështetur financiarisht nga shteti, edhe pse disa prej tyre tashmë përfaqësojnë një përvojë disa vjeçare funksionimi, në kushte mbijetese me problematika financiare dhe menaxhimi efektiv. Megjithatë disa prej klinikave të ligjit kanë shënuar vetëm në pak kohë, rezultate pozitive në drejtim të ofrimit të shërbimeve ligjore falas për qytetarët në nevojë.

Gjatë monitorimit të realizuar, KShH **ka konstatuar**, që organizatat jo-fitimprurëse të kontaktuar nga KShH ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, me mbështetje financiare të donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë, situatë e theksuar në raportet ndërkombëtare dhe e njëjtë prej vitesh<sup>3</sup>. Pavarësisht strategjisë që shteti do të ndjekë për të mundësuar funksionimin efektiv të Klinikave ligjore të atyre organizatave që do të pranojnë mbështetje financiare nga buxheti shtetëror, në të njëjtën kohë është shumë e rëndësishme mbështetja që jep komuniteti i donatorëve për këto Klinika dhe vijueshmëria e kësaj mbështetje në plan afatgjatë. Kjo për arsye se, edhe ky monitorim nxori në pah nevojën e madhe për garantim të aksesit të individëve në skemën e ndihmës juridike falas parësore.

**Statistikat tregojnë se mbi 64% janë kategori që janë subjekte përfituese nga ligji, ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve, mund të jetë potencialisht kategori përfituese, pasi duhet konsideruar që monitorimi ka një përqindje pasaktësie, dhe nëse analizat do të bëheshin në mënyrë më të thelluar mbi gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale, bazuar mbi dokumentacionin përkatës dhe kërkesat e ligjit nr.111/2017, kategoria e atyre subjekteve që kanë nevojë dhe janë përfitues të skemës ligjore falas mund të rezultonte dhe më e lartë.**

Të drejtat e natyrës social - ekonomike listohen si arsyet kryesore përse qytetarët kërkojnë shërbime të ndihmës juridike parësore pranë OJF-ve dhe Klinikave të Ligjit. Edhe nga anketimet me qytetarët, Raporti tregon se nevojat për asistencë i përkasin kategorisë dhe legjislacionit që i përket garantimit të këtyre të drejtave.

KShH rekomandon:

- a) **të plotësohet kuadri nënligjor dhe infrastrukturor** për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në fazat ku akoma ka nevojë për nxitje, shtytje dhe finalizim të akteve;
- b) **të bashkëpunohet dhe koordinohet** me aktorët e parashikuar nga ligji për dhënien e ndihmës juridike parësore falas;
- c) **të fillohet nga ofrimi** i shërbimit të ndihmës juridike falas parësore nga qendrat dhe OJF-të e autorizuar;
- d) **të nënshkruhen** kontratat mes Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me Klinikat Ligjore;
- e) **të promovohet** zbatimi i ligjit për ndihmën juridike falas, me qëllim aksesin në shërbime publike të grupeve vulnerabël.

Promovimi i ligjit dhe ndërgjegjësimi i grupeve përfituese për të drejtat e tyre është një formë njohjeje me standardet e ligjit nga pikëpamja normative dhe teorike. Kjo qasje duhet të përputhet me përgatitjen infrastrukturorë të strukturave të ndihmës juridike, me qëllim përmbushjen e nevojave të komunitetit. Të drejtat nuk duhet të jenë teorike, por praktike dhe efektive, sepse në të kundërt, qytetari humb besimin në sistemin garantues shtetëror të të drejtave të tij, dhe heq dorë nga kërkimi dhe gëzimi i këtyre të drejtave.

<sup>3</sup> Progres -Raporti për Shqipërinë, për vitin 2012.

KShH **rithekson** se moszbatimi i ligjit për ndihmën juridike falas sjell përveçse cënim të së drejtës së aksesit të individëve në nevojë, edhe pasiguri juridike tek protagonistët kryesorë të ofrimit të ndihmës juridike parësore falas, si Qendrat, OJF-të dhe Klinikat e Ligjit. Pritshmëritë e tyre të ligjshme për mbështetje financiare nga shteti, për shkak se vetë ligji ua garanton duket se do duan kohë të realizohen, për sa kohë që akoma ligji është në fazën fillestare të ngritjes së qendrave, dhënies së autorizimeve për OJF-të apo nënshkrimin të kontratave me Klinikat e Ligjit. Kjo fazë infrastrukturore e pandërtuar akoma, vazhdon ta bëjë skemën e ndihmës juridike falas parësore jofunksionale dhe joefikase.

KShH, ka dhënë rekomandimet përkatëse gjatë gjithë Raportit me elementë të caktuar të monitoruar apo hallka veprimi administrativ, por në konkluzion, rekomandon në mënyrë të përsëritur **përpjekje maksimale** dhe **përshpejtim të ritmeve vepruese** të aktorëve përgjegjës sipas ligjit nr.111/2017, në plotësimin e kuadrit infrastrukturor, me qëllim zbatimin korrekt dhe me efikasitet të legjislacionit për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti.

## ▪ OBJEKTI, QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT

Ligji nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", ka për qëllim kryesor: *a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë; b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike; c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efçente dhe efektive. (neni 2).*

Monitorimi, i kombinuar me kuadrin e ri ligjor dhe standardet e kërkuara nga ligji nr.111/2017 synon të sjellë një ndryshim thelbësor në avancimin e funksionimit të skemës juridike falas. Duke besuar në këtë lloj qasje, Raporti "Monitorimi i zbatimit të ligjit për ndihmën juridike falas, në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike parësore", ka analizuar dhe vlerësuar ecurinë e zbatimit të ligjit për ndihmën juridike falas, me fokus të posaçëm ndihmën juridike parësore, në mënyrë të hollësishme, duke përdorur një kombinim metodologjik për arritjen e konkluzioneve objektive dhe profesionale.

Qëllimi i Raportit është:

- **Evidentimi i plotësimimit me kuadrin infrastrukturor nënligjor**, për zbatimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas;
- **Evidentimi i nivelit të zbatimit** të Ligjit për Ndihmën Juridike Falas, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë;
- **Identifikimi i fushave dhe çështjeve**, ku grupet vulnerabël kanë nevojë për shërbimin e ndihmës juridike parësore;
- **Identifikimi i fushave**, ku punonjësit me trajnim të posaçëm, të punësuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, do duhej të trajnoheshin;
- **Evidentimi i zbatimit të legjislacionit** për ofrimin e ndihmës juridike parësore në përputhje me standartet më të mira europiane dhe praktikatat pozitive.

Ky Raport është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet përgjegjëse për krijimin e ndihmës juridike falas. Me qëllim grumbullimin, përpunimin e të dhënave dhe analizimin e statistikave, u ndërmorën këto veprime metodologjike:

- **12 misione monitorimi**, (3 misione për 4 qytetet ku shtrihej zbatimi i nismës, Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, me stenda dhe takime në rrugë), për të konsultuar qytetarët për shërbimet paraligjore, që ju nevojiten;
- **marrje informacioni/takime** pranë Ministrisë së Drejtësisë mbi ecurinë e miratimit dhe zbatimit të akteve, lidhur me ndihmën juridike parësore; ecurinë e përmbushjes së përgjegjësisive nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas lidhur me ofrimin e ndihmës juridike parësore; ecurinë e krijimit të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- **marrje informacioni me anë të korrespondencës/takime**, me organizata, që ofrojnë këshillim ligjor falas, bazuar në listën e vetë KShH, si pjesë e netëorkut të organizatave, që ofrojnë ndihmë juridike falas, por dhe të Ministrisë së Drejtësisë, për ecurinë e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse në kuadër të ligjit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;



- **marrje informacioni** mbi ecurinë e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe atyre të financuara nga OSFA;
- **referimit dhe përdorimit** të burimeve të tjera alternative si; media, interneti, të dhënat e bëra publike në faqe interneti të ndryshme, raporte, statistika, situata konkrete, bazuar mbi raportet e organizatave ndërkombëtare, si; Këshilli i Europës, progres - raportet ndër vite të Komisionit Europian për Shqipërinë, UNDP, OSBE- Prezenca- Shqipëri, etj.

Nga zhvillimi i këtyre aktiviteve monitoruese, dhe përpunimi i të dhënave të dala nga to, u hartua ky raport monitorimi, i cili ekspozon në mënyrë fotografike situatën me ndihmën juridike parësore falas, sipas ligjit nr.111/2017 dhe funksionimin e mekanizmit të ndihmës juridike parësore dhe jep rekomandimet përkatëse konkrete sipas çdo procesi të monitoruar.

## I. MONITORIMI I ECURISË SË MIRATIMIT TË AKTEVE NËNLIGJORE DHE PËRGJEGJËSISË SË INSTITUCIONEVE PËRKATËSE

Ligji nr.111/2017, hyri në fuqi me 1 Qershor 2018. Ministria e Drejtësisë ka përgatitur aktet dytësore dhe formularët e kërkuar sipas ligjit nr.111/2017, që i janë nënshtruar fazës së konsultimit publik me grupet e interesit dhe marrjes së mendimit të disa institucioneve bashkëvepruese me MD. Hyrja në fuqi e këtij ligji solli shfuqizimin e Ligjit të mëparshëm nr.10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar. Aktet dytësore, të detyrueshme për miratim, sipas ligjit nr.111/2017, janë publikuar në faqen zyrtare on-line të Ministrisë<sup>4</sup>. Aktet juridike që janë drejtpërdrejt të lidhura me ndihmën parësore falas, mund të listohen për sa vijon:

1. Udhëzimi nr.1, datë 08.03.2019, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave".<sup>5</sup>
2. Urdhëri nr.226, datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, me shtojcën I- kontrata tip me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.
3. Udhëzimi nr.2, datë 25.03.2019, "Për procedurat e periodicitetit dhe rregullat për rrethanat e kthimit të përfitimeve", i Ministrisë të Drejtësisë.<sup>6</sup>
4. VKM nr.55, datë 06.02.2019 "Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së organizatave jo -fitimprurëse ,që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e përfitimit të tyre".
5. VKM nr.110, datë 06.03.2019, "Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së organizatave jo -fitimprurëse që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e përfitimit të tyre "
6. Urdhëri nr.225, datë 25.03.2019, "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti", me shtojcën I- formulari i kërkesës për ndihmë juridike parësore, shtojca IV- formulari i vetdeklarimit për të ardhurat e pakta; shtojca V- Formulari i deklarimit për kategoritë e posaçme; shtojca VII- formati i regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.<sup>7</sup>
7. Urdhër nr. 59, datë 25.03.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.

Në faqen zyrtare të MD, janë publikuar aktet nënligjore të miratuara me shtojcat përkatëse, në të cilat gjenden formularët në formën e skanuar. **Duke qenë se fokus i monitorimit të realizuar është skema e ofrimit të ndihmës juridike parësore, KShH sugjeroi publikimin e formularit të kërkesës për ndihmë juridike parësore dhe formularit të vetdeklarimit për ndihmë juridike parësore në faqen e institucioneve përgjegjëse<sup>8</sup> në formatin lehtësisht të aksesueshëm për qytetarët, në versionin që mundëson plotësimin e tyre edhe elektronikisht.** Ky sugjerim është bërë nga KShH, nëpërmjet Raportit të Ndërmjetëm datë 4 Korrik 2019 drejtuar MD, dhe rezultoi i

<sup>4</sup> <https://www.drejtësia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

<sup>5</sup> <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/udhezim-nr.-1-dt-08.03.2019-rregullat-dhe-proced-per-mbledhjen-dhe-admin-te-te-dhenave-te-regjistrave.pdf>

<sup>6</sup> <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/UDHEZIM-nr.2-date-25.3.2019-%E2%80%9CPCPER-PROCEDURA-T-PERIOICITETIN-OHE-RREGULLAT-PER-VERIFIKIMIN-E-RRETHANA-VE-PER-KTHIMIN-E-PERFITIMEVE%E2%80%9D.pdf>

<sup>7</sup> <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/URDHER-Nr.225-date-25.3.2019-PER-MIRATIMIN-E-FORMULAREVE-TE-NDIHMES-JURIDIKE-TE-GARANTUAR-NGA-SHTETI.pdf>

<sup>8</sup> Institucione këto të përcaktuara në nenin 35 të Ligjit nr. 111/2017.

realizuar nga konsultimi i faqeve online të Ministrisë së Drejtësisë, ku në fakt Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas nuk ka hapësirë virtuale si e tillë, ku të ekspozohet organika, përbërja, kontaktet.<sup>9</sup>

Brenda muajit Shtator 2018, nga ana e MD-së duhej të ishte miratuar Udhëzimi për procedurat, periodicitetin dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave për kthimin e përfitimeve.<sup>10</sup> KShH konstaton se Udhëzimi nr. 2, është miratuar nga ana e Ministrit të Drejtësisë më datë 25.03.2019, pra me një vonesë mbi 6-mujore.<sup>11</sup> KShH konstaton se afati ligjor i parashikuar nuk është respektuar nga ana e MD-së edhe në rastin e miratimit të Urdhërit për kriteret, metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike, si dhe procedurave të mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas të Shërbimeve të ndihmës juridike.<sup>12</sup> Ky projekt-urdhër mbetet i pritshëm për t'u miratuar, ndërkohë që duhej të ishte miratuar në muajin Shtator 2018<sup>13</sup>.

Me urdhrin nr.59, datë 25.03.2019 të Kryeministrit, është miratuar ngritja e Drejtorisë, organika dhe numri i punonjësve të saj. Në përputhje me organikën e miratuar, (25 punonjës në total), në këtë Drejtori duhet të ushtrojnë funksionin 17 punonjës, ndërsa 8 punonjës do të ushtrojnë funksionin pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, përkatësisht specialistë, (punonjës me trajnim të posaçëm). Nga monitorimi në terren i ndërmarrë nga vëzhguesit e KShH-së me datën 5 Tetor 2019, rezultoi se në këtë Drejtori ushtrojnë funksionin 5 punonjës, që mbanin pozicionet : 1 specialist i burimeve njerëzore; 1 specialist i ndihmës juridike parësore; 1 specialist finance; 1 specialiste e standardeve të ofrimit të ndihmës juridike dhe 1 magazinier. Akoma nuk rezultonte të ishte emëruar Drejtori në krye të kësaj drejtorie.

Përsa më sipër, KShH vëren se procesi i rekrutimit, emërimit si dhe përfundimi i plotësimit të strukturës ka tejkaluar afatet e arsyeshme. Ky konkluzion arrihet duke marrë parasysh faktin se ligji hyri në fuqi në Qershor 2018, ndërkohë organika është miratuar në Mars 2019, dhe deri në Tetor 2019 kjo Drejtori nuk funksionon në kapacitet të plotë burimesh njerëzore dhe profesionale, duke mospërbushur edhe detyrimet dhe kompetencat e veta ligjore.

**Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas, është mekanizmi ndërlidhës i skemës së ofrimit të ndihmës juridike, pa të cilin kjo skemë nuk mund të funksionojë, as në ndihmën parësore dhe as atë dytësore, pavarësisht rolit substancial të gjykatave në ndihmën juridike dytësore.** Detyrimet e saj kryesore, kjo Drejtori akoma nuk i ka realizuar qoftë ato të një natyre të njehershme, (kompetenca draftuese, miratuese), ose ato të një natyre periodike, (kompetenca mbikëqyrëse, administruese, dhe monitoruese).

Për më tepër, kjo Drejtori është gjithashtu kompetente për miratimin e programit të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm të punonjësve, që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendra, pra edhe për ngritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë. **KShH evidenton se duhet përhëndetur fillimi nga puna e kësaj Drejtorie, por sugjeron vëmendje më të shtuar në organizimin dhe funksionimin e saj në kapacitet të plotë dhe në kushte produktive pune.**

<sup>9</sup> <https://www.drejtësia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

<sup>10</sup> Nenet 31, pika 1, dhe 34, pika 2 të Ligjit.

<sup>11</sup> <https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/UDHEZIM-nr.2-date-25.3.2019-%E2%80%9CPCPER-PROCEDURA-T-PERIOICITETIN-OHE-RREGULLAT-PER-VERIFIKIMIN-E-RRETHANA-VE-PER-KTHIMIN-E-PERFITIMEVE%E2%80%9D.pdf>

<sup>12</sup> Nenet 7, gërma f) dhe 34, pika 2 i Ligjit.

<sup>13</sup> <https://drejtësia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

## II. MONITORIMI I OFRIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

### 2.1. QENDRAT E SHËRBIMIT

Në bazë të Ligjit nr. 111/2017 është parashikuar se: “Qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore” është një njësi e specializuar e cila ofron ndihmë juridike parësore nëpërmjet punonjësve me trajnim të posaçëm të punësuar pranë saj. **Punonjës me trajnim të posaçëm** është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimit të posaçëm. Punonjësit ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. **Trajnim i posaçëm** është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore. [neni 3/d, 'dh', 'e'].

**Më 16 Tetor 2019, në qytetin e Elbasanit (pranë Bashkisë), u inagurua e para Qendër e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, me mbështetjen financiare të OSFA**<sup>14</sup>. Brenda këtij viti është parashikuar ngritja e 4 qendrave të tjera, në qytetet Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Pranë secilës prej këtyre qendrave do të ushtrojnë funksionin 2 punonjës me trajnim të posaçëm<sup>15</sup>.

**Gjithsesi, edhe pse jo të krijuara sipas ligjit nr.111/2017, qendra të krijuara dhe të mbështetura në kuadrin e marrëveshjeve dhe donacioneve kanë ekzistuar edhe më parë.** Për shembull, Qendra e Ndihmës Ligjore Falas, pranë ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është krijuar në muajin Janar 2019 dhe ka vijuar ofrimin e ndihmës juridike falas deri në fund të Marsit 2019, në kuadër të projektit “Fuqizimi i grupeve të margjinalizuara përmes ofrimit të ndihmës juridike falas”, i zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore, me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, (PNUD) dhe fonde të Ambasadës Britanike. Nga monitorimi rezultoi se ndihma që ofrohet nga kjo qendër konsiston kryesisht në përgatitjen e kërkesave apo ankimeve, informimi mbi mjetet dhe rrugët ligjore të zgjidhjes së problemeve, ofrimi i konsulencës dhe këshillimi lidhur me procesin apo rrugët alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjatë veprimtarisë së saj, kjo zyrë ka vepruar brenda të gjitha standarteve profesionale, duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave. Problematikat që janë trajtuar me shpesh nga kjo zyrë janë kryesisht të natyrës administrative dhe që kanë të bëjnë me: sigurimet shoqërore dhe pensionet; mbifaturimet lidhur me shërbimet e ujit dhe energjisë elektrike dhe gjobot.

Qendra e Ndihmës Ligjore Falas, pranë ambienteve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër përgjatë periudhës janar - shkurt 2019 rezultoi se ka ofruar ndihmë juridike parësore për 147 raste<sup>16</sup>. Sikundër konstatohet nevoja për ndihmë juridike është e lartë, element i cili reflekton domosdoshmërinë e përmbyshjes së nevojave të komunitetit, nga ana e këtyre qendrave.

### 2.2. ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE

**Organizatat jofitimprurëse** japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organizatat jofitimprurëse të autorizuar për

<sup>14</sup><http://www.osfa.al/ngjarje/inagurohet-qendra-e-ndihmes-paresore-ne-qytetin-e-elbasanit>

<sup>15</sup> Sipas konfirmimeve nga monitorimi në terren nga vëzhguesit e KShH-së pranë DJNF me 5 Tetor 2019.

<sup>16</sup> Sipas relacionit dhe raportimit të vëzhguesve të KShH, datë 05.03.2019.

dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. [neni 15/1 dhe 15/3].

Organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga ana e Ministrit të Drejtësisë janë parashikuar nga ana e Ligjit si subjekte për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore. Miratimi i kontratave tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, dhe me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në respektim të nenit 34, pika 2 të Ligjit nr. 111/2017, duhej të ishte realizuar *brenda 3 muajve* nga hyrja në fuqi e ligjit. **Është pozitiv fakti se këto kontrata tip rezultojnë të jenë miratuar nga ana e Ministrit të Drejtësisë nëpërmjet Urdhërit nr.226, datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.**<sup>17</sup> Megjithatë për këtë akt juridik vërehet një *vonesë 9 mujore*.

Këshilli i Ministrave ka qenë i detyruar që brenda afatit 3 mujor nga hyrja në fuqi e ligjit të përcaktonte me vendim procedurat dhe dokumentacionin për autorizimin e organizatave jofitimprurëse.<sup>18</sup> **KShH konstaton se procedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentacioni përkatës që duhet depozituar për t’u pajisur me autorizim janë miratuar nëpërmjet VKM nr.55, datë 06.02.2019,<sup>19</sup> pra *rreth 8 muaj me vonesë* nga afati ligjor i parashikuar.**

Mosrespektimi i afatit ligjor të parashikuar në nenin 34, pika 1 të Ligjit nr. 111/2017, është konstatuar edhe në detyrimin ligjor që ligjvënësi i ka njohur Këshillit të Ministrave për të miratuar procedurat dhe rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara. Këto procedura dhe rregulla të përcaktuara nëpërmjet VKM nr.110, datë 06.03.2019,<sup>20</sup> synojnë të normojnë procesin konkurrues dhe transparent mbi bazën e të cilit organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, të financuara nga buxheti i shtetit. **Në kushtet që edhe pse Drejtoria është krijuar dhe janë hartuar dhe kontratat tip, procesi i përzgjedhjes dhe lidhja e kontratave me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, nuk është realizuar akoma<sup>21</sup>. Për rrjedhojë, Regjistri i OJF -ve që ofrojnë ndihmë juridike falas, është akoma i paplotësuar edhe pse i krijuar dhe i publikuar online formati i Regjistrimit.**

Nga monitorimi i realizuar nga KShH rezultoi se përsa i përket procedurës së ofrimit të ndihmës juridike parësore nga ana e OJF-ve, ende nuk është hapur thirrja dhe nuk ka filluar procesi i konkurrimit, për shkak të mungesës së plotësimit të numrit të anëtarëve për komisionin vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara; si dhe komisionin e ankimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit, të vendimeve për përzgjedhjen e organizatave jofitimprurëse të autorizuara që përfitojnë financim, si edhe të masës së financimit<sup>22</sup>.

Gjatë periudhës së monitorimit, nga muaji Dhjetor 2018 e deri më sot, organizatat jofitimprurëse të kontaktuar nga KShH ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore, me

<sup>17</sup> <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/URDHER-Nr.226-date-25.3.2019-PER-MIRATIMIN-E-KONTRA-TA-VE-TE-NDIHMES-JURIDIKE-TE-GARANTUAR-NGA-SHTETI.pdf>

<sup>18</sup> Neni 34, pika 1 i Ligjit.

<sup>19</sup> Publikuar në FZ nr. 15, datë 12.02.2019, faqe 514.

<sup>20</sup> Publikuar në FZ nr. 32, datë 15.03.2019, faqe 1412.

<sup>21</sup> Sipas konfirmimeve nga monitorimi pranë DNJF me 5 Tetor 2019.

<sup>22</sup> Sipas gjetjeve nga monitorimi në terren nga vëzhguesit e KShH pranë Drejtorisë më 5 Tetor 2019.

**mbështetjen financiare të donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë.** Ndërkohë që, nga kontakti që KShH realizoi në terren me një pjesë të këtyre organizatave vërehet se fondet e vendosura në dispozicion nga donatorët kanë pësuar tkurrje, çka ka ndikuar në kufizimin e hapësirave për t'i ofruar shërbime ligjore falas qytetarëve në nevojë.

Konkretisht, nga monitorimi i organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore në Durrës, u theksua prej tyre se suprimimi i menjëhershëm i KSHNJ-së ka sjellë disa problematika, pasi kanë mbetur pa u paguar shpenzimet e avokatëve të kontraktuar nga ky Komision, ndërkohë që proceset gjyqësore vazhdojnë akoma dhe nuk është dhënë një vendim i formës së prerë. Pranë qendrave ka patur në vijimësi një numër të madh kërkuesish për të përfituar, por nuk është bërë i mundur ofrimi i shërbimit. Në përgjithësi, rastet janë trajtuar duke u ofruar ndihmë juridike parësore, si dhe i është ofruar ndihmë juridike dytësore viktimave të dhunës në familje, apo grave në vështirësi ekonomike. Një tjetër problematikë e dukshme për qytetin e Durrësit, është mungesa e qendrës pritëse 24-72 orë për strehimin e viktimave të dhunës në familje<sup>23</sup>.

Ndërsa në Shkodër, organizata "Intelektualët e Rinj Shpresë" është një organizatë jofitimprurëse e hapur në Tetor të vitit 2018, e cila ka në fokus dhënien e ndihmës parësore për individët, të cilët për shkak të rrethanave financiare apo sociale e kanë të pamundur ta sigurojnë atë. Kjo organizatë, që nga muaji Prill i vitit 2019 në kuadër të një projekti me në fokus të rinjtë, e ka përqëndruar veprimtarinë e saj në trajtimin e problematikave të ndryshme ligjore që has kjo grup moshë në marrëdhënie me institucionet, si dhe në orientimin e tyre në tregun e punës.<sup>24</sup>

### **2.3. KLINIKAT E LIGJIT**

**Klinikat ligjore të ngritura pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë** japin ndihmë juridike parësore. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore. [neni 17]. Sipas nenit 16 të Ligjit nr.111/2017, ofrimi i ndihmës juridike do të realizohet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura ndërmjet klinikave të ligjit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. **Edhe pse Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është krijuar, akoma nuk ka marrëveshje mes palëve sipas parashikimeve ligjore. Drejtoria ishte në proces të draftimit të kontratës tip me Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve, por për këtë nuk kishte një afat konkret për ta finalizuar si proces. Nga ana e përfaqësuesve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ende nuk është realizuar asnjë bashkëbisedim dhe takim me përfaqësues të Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve<sup>25</sup>.**

Gjatë monitorimit të realizuar, KShH ka konstatuar që disa prej Klinikave të Ligjit kanë shënuar vetëm në pak kohë rezultate pozitive në drejtim të ofrimit të shërbimeve ligjore falas për shtetasit në nevojë. Nga ana tjetër, monitorimi i KShH-së evidentoi edhe disa problematika funksionale, të cilat do të ndikojnë në ofrimin e ndihmës juridike parësore nga ana e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve, deri në rregullimin e statusit të tyre në raport me institucionin. Sipas parashikimeve të ligjit nr. 111/2017, kjo njësi përbërëse e IAL-së, e cila është e organizuar dhe

<sup>23</sup> Monitorime të datës 12.07.2019 me “Shoqata e Grave me Probleme Sociale”, Qendrës QZHK “Qendra për Zhvillim Komunitar” – Sot për të ardhmen”, dhe Shoqatës së Grave me probleme sociale (SHGPS).

<sup>24</sup> Monitorime të datës 05.03.2019.

<sup>25</sup> Sipas gjetjeve nga monitorimi në terren nga vëzhguesit e KShH pranë Drejtorisë me 5 tetor 2019

funksionon sipas legjislacionit për arsimin e lartë ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në Statutin e IAL-së.<sup>26</sup>

**KShH ka monitoruar funksionimin e Klinikës së Ligjit pranë IAL-ve publike, në 3 qytete të vendit, përkatësisht Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit Tiranë (FDUT), Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD), dhe Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Ndërkohë pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi" në qytetin e Shkodrës nuk rezulton të jetë ngritur dhe të ushtrojë funksionin klinika e ligjit.**

U vërejt se Klinika e Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, është parashikuar si pjesë e kurrikulave universitare përgjatë cikleve të studimit. Klinika e Ligjit është funksionale që nga viti 2011, ndonëse në kohëra të ndryshme, organizimi dhe funksionaliteti i klinikës është përceptuar dhe materializuar në një format ndryshe nga ai që ka sot. Klinika e Ligjit deri në vitin 2016 (para 3 viteve) është mbështetur financiarisht nga OSBE, dhe më pas nga USAID-i në kuadër të projektit "JUST", bashkëpunim ky i cili është ndërprerë për shkak të disa rrethanave kryesisht të natyrës objektive. **Lidhur me financimin rezulton se kjo klinikë nuk është mbështetur nga shteti për ofrimin e ndihmës juridike në kuadër të klinikës, as pas miratimit të ligjit 111/2017.**

Disa nga veçoritë në këtë klinikë janë çështjet e menaxhimit të saj. *De jure*, Klinika administrohet nga një bord, i cili përbëhet nga organet drejtuese të Fakultetit. Aktualisht ky bord nuk është funksional. Një tjetër sfidë është edhe ngarkesa e pedagogëve. Këta të fundit, krahas orëve mësimore duhet të japin kontributin e tyre pranë Klinikës. Orët e shpenzuara pranë Klinikës nuk përlloragiten gjatë hartimit të planit mësimor. Kjo sjell kategorizimin e këtyre orëve, si orë shtesë. **Me nënshkrimin e marrëveshjes me Drejtorinë për Ndihmën Juridike Falas, kjo Klinikë ka pritshmëri lidhur me përfshirjen e saj në më shumë aktivitete, si dhe mbulimin e mëtejshëm financiar të saj, me qëllim shmangien e rrezikut të mbylljes dhe vijueshmërinë e veprimtarisë së Klinikës**<sup>27</sup>.

Në universitetet publike të qyteteve të Durrësit dhe të Vlorës, statutet e IAL-ve përkatëse nuk i kanë të parashikuara funksionimin e Klinikave të Ligjit. KShH konstatoi se këto 2 Klinika, janë ngritur dhe funksionojnë mbi bazën e një marrëveshjeje ndërmjet donatorit dhe IAL-së, në zbatim të nismës 'Për themelimin e Klinikave Vendore të Ligjit', së zbatuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, nëpërmjet Lëviz Albania, me mbështetjen financiare të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri.

**Klinikat e Ligjit pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, (UAMD) dhe Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, njësoj si Klinika e Ligjit pranë FDUT (Tiranë), nuk janë financuar nga shteti për ofrimin e ndihmës juridike në kuadër të klinikës, jo vetëm para, por as pas miratimit të ligjit 111/2017, ku në nenin 3 të tij e ka të përcaktuar si taksative garantimin e financimit nga shteti.**

Për më tepër, disa veçori të konstatuara në Klinikën e Ligjit pranë Universitetit të Vlorës, lidhen me faktin se kjo klinikë funksionon në një zonë shumë të frekuentuar nga qytetarët dhe është lehtësisht e aksesueshme. Klinika e Ligjit pas diskutimit me institucionin e Avokatit të Popullit ka shtrirë efektet edhe në Fier, duke dhënë shërbime të ndihmës juridike parësore. Klinika ofron ndihmë

<sup>26</sup> Neni 3, gërma ë) i Ligjit.

<sup>27</sup> Monitorime të datës 27.02.2019 dhe datë 15.10.2019.

juridike parësore dhe dytësore, e fokusuar në realizimin e këshillimeve ligjore, por edhe në ndjekjen e proceseve gjyqësore.<sup>28</sup>

Ndërsa, në Klinikën e Ligjit pranë Universitetit të **Durrësit** janë konstatuar këto veçori: është rritur përfshirja e studentëve nga 10-12 studentë, në 20 që ofrojnë kontributin e tyre modest me anë të ofrimit të informacionit për legjislacionin në fuqi, këshillime ligjore, madje dhe shoqërimin e personave në institucionet përkatëse. Lidhur me çështjet për të cilat Klinika ka ofruar ndihmë juridike, i përkasin natyrës civile dhe administrative. Gjithashtu, ajo ka ndjekur një numër të konsiderueshëm edhe çështjesh strategjike, më së shumti mjedisore. Gjithsej, numri i çështjeve të trajtuara me ndihmë juridike parësore dhe dytësore ishte 267. Krahasuar me monitorimin e fundit vërehet dukshëm rritje, pasi numri i mëparshëm i çështjeve ishte 239.<sup>29</sup>

Sa i përket Klinikës së Ligjit, **Shkodër**, ashtu si dhe Klinika Ligjore në Durrës dhe Vlorë, veprimtarinë e ka nisur si një projekt pilot, i mbështetur financiarisht nga OSFA, i cili në parim është parashikuar për t'u zbatuar, në një plan kohor që shtrihet nga fillimi i muajit Dhjetor 2018 deri në muajin Maj 2019, në kuadër të projektit Për Themelimin e Klinikave Vendore të Ligjit<sup>30</sup>. **Në qytetin e Shkodrës, KShH konstatoi se Klinika e Ligjit e financuar në kuadër të nismës së sipërcituar, nuk është e vendosur në ambientet e Universitetit Publik.**

Nga sa më lart konstatohet se nga njëra periudhë monitorimi në tjetrën gjendja nuk ka ndryshuar sa i përket mbështetjes financiare të klinikave, të cilat funksionojnë kryesisht për shkak të përfshirjes në projekte të ndryshme dhe përthithjes së donacioneve të aktorëve ndërkombëtarë, apo menaxhimit. Kjo gjendje ka ndryshuar sa i përket përballimit të ngarkesës, *dukshëm në rritje*, përpunimit të kërkesave për informacion dhe nevojës së madhe të qytetarëve për këshilla ligjore. Ekspozimi në rritje të kërkesave për ndihmë juridike parësore, duke iu drejtuar edhe klinikave ligjore pranë universiteteve, tregon edhe profilizim të këtyre klinikave dhe për rrjedhojë dhe cilësi më të lartë të tyre ndaj ofrimit të këtij lloji shërbimi ndaj kategorive në nevojë.

## **2.4. ANKETIMET ME QYTETARËT**

Sipas nenit 17 të ligjit nr.111/2017, është parashikuar një procedurë specifike për dhënien e ndihmës juridike parësore, nga qendrat, OJF- të dhe klinikat e ligjit.

Megjithatë, KShH, përveç monitorimeve pranë qendrave, OJF-ve, dhe Klinikave, të cilat e ofrojnë shërbimin sipas procedurës përmendur më lart, (*supra, prg.50*), u konsultua dhe me qytetarët për të vlerësuar fushat ku ata kanë më tepër nevojë dhe domosdoshmëri për shërbimin e ndihmës juridike parësore. **Gjatë monitorimeve të realizuara në 4 qytete të ndryshme të vendit, konkretisht në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, KShH është njohur me ankesa të ndryshme të referuara nga qytetarët, të cilët nuk kishin njohuri të mjaftueshme mbi legjislacionin e ri për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti, si dhe nuk dispononin kopje të formularëve/kërkesave për të kërkuar ndihmë juridike pranë institucioneve të ngarkuara me ligj për ta ofruar atë, edhe pse tashmë ato janë të aksesueshme *online*.**


<sup>28</sup> Monitorime të datës 28.02.2019, 1.08.2019, dhe 7.10.2019

<sup>29</sup> Monitorime të realizuara në datat 12.07.2019 dhe 17.09.2019.


<sup>30</sup> Monitorime të datës 5.03.2019 dhe 17.10.2019. Në këtë qytet është realizuar monitorim edhe pranë Klinikës së Ligjit të Qendrës Vatra (OJF) në qytetin e Vlorës, e njohur për trajtimin e çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje.



U anketuan 451 qytetarë në të katër (4) qytetet e vendit<sup>31</sup>. Monitorimi tregoi se kategoria e përfituesve nga ligji për ndihmën juridike përbën 64% nga totali i të anketuarve. Në të këtë shifër statistikore, përfshihen si subjektet me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme dhe subjektet që përfshihen në kategorinë e e veçantë të përfituesve, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë<sup>32</sup>.



Lidhur me kategorinë e personave me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme, ato përbëjnë 28% nga totali i të anketuarve, edhe pse profili i tyre si me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme është një profil i specifikuar/identifikuar *prima facie*, nisur nga të dhënat fillestare të informacionit të përpunuar nga monitoruesit. Gjatë kontaktit, shtetasit nuk paraqitën dokumentacion provues mbi paaftësinë e tyre paguese.



<sup>31</sup> Në Tiranë 124 të anketuar, Durrës 176 të anketuar, Shkodër 51 të anketuar dhe Vlorë 100 të anketuar.

<sup>32</sup> Neni 11 i ligjit nr.111/2017.

**Sa i përket nevojave, sipas fushave, nga anketimet mund të identifikohen nevoja për asistencë juridike në grupin dhe paketën e të drejtave me natyrë social - ekonomike, ndërthurur dhe me të drejtën familjare dhe detyrimet që rrjedhin prej saj.** Konkretisht, në anketimet e realizuara në **Tiranë** me 124 anketues, grup - çështjet që shqetësonin qytetarët ishin të lidhura me të drejtën e pronës dhe të drejtën për strehim, (legalizimet, pjestimi i pasurisë, konflikte,); me të drejtën familjare, (zgjidhje martesë, kujdestari, interesi më i lartë i fëmijës); me të drejtën për sigurime shoqërore, si dhe të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e punësimit. Në anketimet e realizuara në **Durrës** me 176 anketues, grup - çështjet që shqetësonin qytetarët ishin të lidhura me të drejtën e pronës, (legalizimet), me të drejtën familjare, (zgjidhje martesë, kujdestari, interesi më i lartë i fëmijës); si dhe me aksesin në gjykatë. Në anketimet e realizuara në **Shkodër** me 51 anketues, grup - çështjet që shqetësonin qytetarët ishin të lidhura me të drejtën e pronës dhe të drejtën për strehim, (regjistrimet në hipotekë, pjestimi i pasurisë); me të drejtën familjare, (zgjidhje martesë); me të drejtën për sigurime shoqërore. Në anketimet e realizuara në **Vlorë** me 100 anketues, grup - çështjet që shqetësonin qytetarët ishin të lidhura me të drejtën e pronës dhe të drejtën për strehim; me të drejtën familjare, (kujdestari, interesi më i lartë i fëmijës); me të drejtën për ndihmë shoqërore, si dhe me të drejtën për shërbime publike cilësore të furnizimit të energjisë elektrike, (mbifaturime).

Nisur nga të dhënat e realizuara nga anketimit, trajnimi i posaçëm i cili përfshin trajnim fillestar dhe trajnimin vazhdues për punonjësit e punësuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, do të duhej të orientohej, në këto drejtime sektoriale bazuar mbi fushën:

- ✓ garantitë kushtetuese të përfitimit të të drejtave të natyrës social- ekonomike, përfshirë dhe të drejtën e pronës që qëndron në themel të kësaj të drejte;
- ✓ legjislacioni shqiptar mbi të drejtën dhe aksesin e qytetarëve në shërbimet publike të lidhura me regjistrimin e pronës, me përfitimin e energjisë elektrike, në përfitimin e ndihmës ekonomike.
- ✓ legjislacioni shqiptar lidhur me të drejtën familjare dhe aksesit në gjykatë për çështje të lidhura me konflikte apo zgjidhje që i përkasin kësaj fushe.

Trajnimi i posaçëm i cili përfshin trajnim fillestar dhe trajnimin vazhdues dhe që sipas ligjit miratohet nga DNJF, do të duhej të fokusohet në legjislacionin që targeton individë dhe kategori si:

- ✓ viktima të dhunës në familje;
- ✓ viktima të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- ✓ viktima të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ✓ fëmijë, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- ✓ persona që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- ✓ persona, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale.

### III. GJETJET KYÇE DHE REKOMANDIME

KShH rithekson dhe rivlerëson se ligji nr.111/2017, reformon tërësisht skemën e ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, duke përcaktuar rregulla, procedura dhe mekanizma të rinj në ofrimin dhe garantimin e këtij shërbimi. Risitë e shumta që ky ligj sjell në këtë qasje të re përbëjnë padyshim një sfidë, për të gjithë aktorët shtetërorë, ose jo shtetërorë, që përfshihen në këtë proces. **Në këtë kuptim, duhet të demonstrohen vazhdimisht veprime aktive, me synim ndërgjegjësimin e grupeve vulnerabël për rolin dhe rëndësinë e përfitimit nga ndihma juridike parësore falas si dhe mekanizmat ligjore të përfitimit të saj. Po ashtu duhen eksploruar dhe zbatuar metoda dhe forma të koordinimit, qofshin këto klasike ose inovatore, mes organeve publike dhe jo publike.** Kjo me synimin për të forcuar bashkëpunimin në funksion të qëllimit madhor për zbatimin efektiv të ndihmës juridike parësore falas.

Nga ana tjetër, edhe pse ndërgjegjësimi i grupeve përfituese për të drejtat e tyre dhe aksesin sipas këtij ligji, është formë njohjeje me standardet e ligjit nga pikëpamja normative dhe teorike, kjo qasje duhet të shkojë në të njëjtën linjë zhvillimi me përgatitjen infrastrukturore të strukturave të ndihmës juridike për t'i plotësuar këto nevoja. **Të drejtat nuk duhet të jenë iluzionare dhe teorike, por praktike dhe efektive, sepse në të kundërt, qytetari humb besimin në sistemin garantues shtetëror të të drejtave të tij, dhe heq dorë nga kërkimi dhe gëzimi i këtyre të drejtave.** Por sikundër e theksuam, moszbatimi i ligjit sjell përveç cenim të së drejtës së aksesit të individëve në nevojë, edhe pasiguri juridike tek protagonistët kryesorë të ofrimit të ndihmës juridike parësore falas, si Qendrat, OJF-të dhe Klinikat e Ligjit. Pritshmëritë e tyre të ligjshme për mbështetje financiare nga shteti, për shkak se vetë ligji ua garanton duket se do duan kohë të realizohen.

Ndihma parësore falas, është faktor kyç lidhur me garantimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve, sepse ajo mbulon ofrimin e informacionit të domosdoshëm mbi metodat dhe procedurat përkatëse të aksesit parajyqësor të grupeve vulnerabël. **Ndihma parësore ka një rëndësi të jashtëzakonshme jo vetëm për garantimin e të drejtës për informim të qytetarit për të drejtat e tij lidhur me aksesin në shërbime publike dhe aksesin në institucionet publike, por edhe edukimin e tij me zgjidhjen e çështjeve në mënyra të tjera ndërmjetësimi, para gjyqësore.** Kjo zgjidhje për rrjedhojë sjell dhe përfitime të tjera të karakterit publik, si mosdërgimi i çështjeve në gjykatë, duke zvogëluar ngarkesën e tyre, zgjidhja në rrugë administrative me sa më pak kohë e energji, duke e bërë zgjidhjen juridike eficiente, etj.

Ky Raport Monitorimi përmbushi objektivat e tij, në lidhje me evidentimin e plotësimit me kuadrin infrastrukturor nënligjor, për zbatimin e Ligjit për Ndihmën Juridike Falas; evidentimin e nivelit të zbatimit të Ligjit për Ndihmën Juridike Falas, nga organizatat jofitimprurëse, si dhe klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë; identifikimin e fushave dhe çështjeve, ku grupet vulnerabël kanë nevojë për shërbimin e ndihmës juridike parësore; identifikimin e fushave, ku punonjësit me trajnim të posaçëm, të punësuar pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, do duhej të trajnoheshin; evidentimin e zbatimit të legjislacionit për ofrimin e ndihmës juridike parësore në përputhje me standartet më të mira europiane dhe praktikat pozitive.

Rezultatet e monitorimit, mbi ecurinë e ligjit për ndihmën juridike falas, të lidhura kryesisht me ndihmën juridike parësore, tregojnë se **vonesat** lidhur me aktet dytësore nënligjore, dhe në ngritjen dhe funksionimin e Drejtorisë kanë pasur impakt të konsiderueshëm në ofrimin e ndihmës juridike falas, si në planin e ndihmës parësore dhe atë dytësore, që KShH e ka evidentuar dhe në

Raportin studimor, Shkurt 2019<sup>33</sup>. Vonesa ka gjithashtu në krijimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve falas, në procesin e konkurrimit të OJF- ve dhe lidhjen e kontratave me OJF - të, që ofrojnë ndihmë juridike parësore si dhe me mbështetjen financiare ndaj klinikave të ligjit pranë Universiteteve të monitoruara.

Edhe ky monitorim nxori në pah nevojën e madhe për garantim të aksesit të individëve në skemën e ndihmës juridike falas. Statistikat tregojnë se mbi 64% janë kategori që janë subjekte përfituese nga ligji, ndërsa pjesa tjetër e të anketuarve, mund të jetë *potencialisht kategori përfituese*, pasi duhet konsideruar që monitorimi ka një përqindje pasaktësie, dhe nëse analizat do të bëheshin në mënyrë më të thelluar mbi gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale, bazuar mbi dokumentacionin përkatës dhe kërkesat e ligjit nr.111/2017, kategoria e atyre subjekteve që kanë nevojë dhe janë përfitues të skemës ligjore falas mund të rezultonte dhe më e lartë.

**Të drejtat e natyrës social - ekonomike, duke shtuar edhe ato të natyrës mjedisore, me impakt në të drejtën për kujdes shëndetësor, listohen si fusha dhe veprimtaria më e gjerë që hulumtohet nga OJF-të dhe Klinikat e Ligjit gjatë misionit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre për dhënie ndihme juridike falas në format e parashikuara nga ligji dhe të emërtuara si shërbime paraligjore, forma këshillimi ose asistencë në institucionet e administratës publike.** Por edhe nga anketimet me qytetarët, Raporti tregon se nevojat për asistencë i përkasin kategorisë dhe legjislacionit që i përket garantimit të këtyre të drejtave. Edhe trajnimet e posaçme të personave të punësuar në qendrat e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, duhen orientuar kryesisht me njohjen e standardeve të efikasitetit dhe efikasitetit të kërkuara prej organeve të administratës publike kompetente për zbatimin e legjislacionit socio-ekonomik.

Në përmbledhje të analizës dhe gjetjeve për sa më lart, KShH rekomandon:

**Rekomandimi 1: Të përshpejtohen ritmet** për funksionimin në kapacitet të plotë burimesh njerëzore dhe kushte të përshtatshme pune, të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, me një rol kyç mbi funksionimin e skemës juridike falas.

**Rekomandimi 2: Të realizohet koordinim më i mirë** mes institucioneve përgjegjëse për realizimin e skemës së ndihmës juridike parësore falas në mënyrë funksionale, duke konsideruar që MD si dhe institucione të tjera të përfshira në ligj për ngritjen e qendrave dhe mbështetjen e klinikave të ligjit që ekzistojnë, duhet të bashkëpunojnë mes tyre. Universitetet publike të qyteteve të Durrësit dhe të Vlorës, duhet të parashikojnë në statutet e IAL-ve përkatëse funksionimin e Klinikave të Ligjit. Gjithashtu, një vëmendje e shtuar i duhet kushtuar financimit të menjëhershëm me qëllim rifunksionalitetin e Klinikës së Ligjit pranë FDUT-së (Tiranë).

**Rekomandimi 3: Të realizohet ngritja sa më parë e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike falas, duke filluar nga 4 të programuarat, të parat në listë, nga 12 të planifikuarat për çdo qark<sup>34</sup>;**

---

<sup>33</sup> Për më tepër shih Raportin Studimor, "Mbi ndihmën juridike të garantuar nga Shteti dhe respektimin e standardit të aksesit në drejtësi të grupeve vulnerabel", në kuadër të projektit "Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika Ligjore XII", mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze", Shtator 2018 - Shkurt 2019, i disponueshëm në: [http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH\\_Shkurt-2018.pdf](http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf)  
[http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH\\_Shkurt-2018.pdf](http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/02/Studimi-legal-aid-KShH_Shkurt-2018.pdf)

<sup>34</sup> <https://drejtesia.gov.al/newsroom/lajme/ndihme-juridike-falas-ne-cdo-qark-gjonaj-peruron-qendren-e-elbasanit/>

**Rekomandimi 4:** Të realizohet procesi i konkurrimit dhe dhënia e autorizimit për OJF- e licensuara, si dhe të plotësohet regjistri me OJF që ofrojnë ndihmë juridike parësore falas;

**Rekomandimi 5:** Të realizohet përsheptimi i procesit të nënshkrimit të kontratave me Klinikat Ligjore të IAL dhe financim të veprimtarisë së tyre;

**Rekomandimi 6:** Të garantohet akses dhe të merren masat e nevojshme për publikimin e formularëve të ndihmës juridike në format të aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuar<sup>35</sup>.

**Rekomandimi 7:** Trajnimi i posaçëm duhet të **fokuset dhe orientohet në trajnime** të punonjësve të Qendrave të Shërbimeve të Ndhmës Ligjore Falas, me legjislacionin *substancial* dhe *procedural* që lidhet me fushën e të drejtave të natyrës social - ekonomike, si dhe me kategorinë e grupeve vulnerabël me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme si dhe me problematikat e kategorive të posaçme si grupe në nevojë për akses dhe ndihmë juridike falas.

## ANEKS

- Ligji nr.111/2017, "Për Ndhmën Juridike të garantuar nga Shteti"

- **Për më tepër:**

<https://www.drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

---

<sup>35</sup>Neni 7/a i Ligjit Nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

**LIGJ Nr. 111/2017**

**PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË VENDOSI:

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Neni 2

**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj ka si qëllim:

- a) të krijojë një sistem për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;
- b) të sigurojë mirorganizimin, miradministrimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike;
- c) të sigurojë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Neni 3

**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Ndhmë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantojnë dhe financohen nga shteti.
- b) “Ndhmë juridike parësore” është:
  - i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
  - ii) dhënia e këshillimit;
  - iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
  - iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
  - v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe
  - vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

- c) “Ndhimë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.
- ç) “Këshillim” është dhënia e informacionit mbi mënyrat dhe mundësitë e zgjidhjes së një çështjeje konkrete juridike.
- d) “Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore” është një njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
- dh) “Punonjës me trajnim të posaçëm” është punonjësi, i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimi të posaçëm, i cili ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.
- e) “Trajnim i posaçëm” është programi i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, i miratuar nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, për punonjësit që ofrojnë ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.
- ë) “Klinikë ligjore” është njësi përbërëse e një institucioni të arsimit të lartë, e organizuar dhe që funksionon sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që ofron ndihmë juridike parësore pa qëllim fitimi, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.
- f) “Të ardhura”, në kuptim të këtij ligji, janë të ardhurat mujore që sigurohen nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhurat nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihet ndihma ekonomike, pensioni social, pagesat e papunësisë, përfitimet e invalidëve, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, rimbursimi i shpenzimeve për energji, rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.
- g) “Familje”, në kuptim të këtij ligji, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore ose bashkëjetese, si dhe marrëdhëniet prindër-fëmijë, marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, që jetojnë në të njëjtën strehë dhe që kontribuojnë bashkërisht, financiarisht ose në mënyra të tjera për përballimin e koston së jetesës.
- gj) “Pasuri”, në kuptim të këtij ligji, është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore. Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nuk konsiderohen pasuri, sipas kuptimit të këtij ligji.
- h) “Përrjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore” është një formë e ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj.
- i) “Tarifa gjyqësore” është tarifa, sipas kuptimit të dhënë nga legjislacioni në fuqi për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.
- j) “Shpenzimet gjyqësore” janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin, sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin procedural, përveç tarifës gjyqësore.
- k) “Tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit” është tarifa që i parapaguhet shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 4

### **Parimet e ndihmës juridike**

Dhënia e ndihmës juridike bazohet në parimet e mëposhtme:

- a) aksesit të barabartë të individëve në ndihmën juridike;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike;
- ç) cilësisë, efikasitetit dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike;
- d) ruajtjes së konfidencialitetit;
- dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël.

#### Neni 5

### **Format e ndihmës juridike**

Ndihma juridike jepet në format e mëposhtme:

- a) ndihmë juridike parësore;
- b) ndihmë juridike dytësore;
- c) përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas ligjit, dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

## KREU II

### ORGANIZIMI I NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

#### Neni 6

### **Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike**

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- a) Ministri i Drejtësisë;
- b) Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas;
- c) Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- ç) gjykatat kompetente, sipas parashikimeve të këtij ligji.

#### Neni 7

### **Detyrat e Ministrit të Drejtësisë**

Ministri i Drejtësisë ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:

- a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- b) i propozon Ministrisë së Financave projektbuxhetin vjetor për ndihmën juridike, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor;
- c) mbikëqyr mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike dhe zbatimin e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;
- ç) raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;
- d) miraton aktet e mëposhtme:
  - i) formularin e kërkesës për ndihmë juridike parësore;
  - ii) formularin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore;
  - iii) formularin e kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore;
  - iv) formularin e vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore;
  - v) formularin e vetëdeklarimit të të ardhurave dhe të pasurive, sipas këtij ligji;
  - vi) formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta, sipas nenit 11 të këtij ligji;
  - vii) formatin e regjistrimit për regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të mësipërme;
  - viii) formatin e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
  - ix) formularin e ankimit ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore.



Ministria e Drejtësisë merr masat e nevojshme për publikimin e formularëve të parashikuar në këtë paragraf në format të aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara;

dh) miraton krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor;

e) miraton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrisë përgjegjëse për financat;

ë) miraton kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore;

f) miraton, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike;

g) miraton me udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifave përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;

gj) miraton procedurat që ndiqen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në lidhje me pagesat për shpenzimet gjyqësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

h) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuar që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;

i) miraton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;

j) kryen të gjitha detyrat etjera të përcaktuara me këtë ligj.

## Neni 8

### **Detyrat e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas**

1. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është person juridik publik nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë, në kuptimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Organizimi i brendshëm i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë. Marrëdhëniet e punës të punonjësve me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe të personelit ndihmës të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas rregullohen sipas Kodit të Punës.

2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen këto detyra:

a) zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;

b) i paraqet Ministrit të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike;

c) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënien e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë për t'u përfshirë në buxhetin e shtetit;

ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike;

d) mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj;

dh) harton raportet vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë;

- e) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut;
- ë) harton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- f) lidh kontrata me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe kryen pagesat përkatëse;
- g) bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm;
- gj) administron, bazuar në urdhrin përkatës të Ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore;
- h) publikon listën e avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
- i) publikon kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, pas miratimit nga Ministri i Drejtësisë;
- j) kryen pagesat, bazuar në tarifin përkatës të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- k) lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore;
- l) zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike;
- ll) mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët;
- m) zbaton rregullat për rimbursimin e pagesave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe mbron interesat e buxhetit të shtetit;
- n) harton dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë aktet nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- nj) mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë;
- o) kryen të gjitha detyrat e tjera që i caktohen me këtë ligj.

## Neni 9

### **Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë**

Dhoma Kombëtare e Avokatisë kryen këto detyra:

- a) miraton me udhëzim të përbashkët me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
- b) miraton, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas parashikimeve të nenit 24, të këtij ligji, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga dhomat vendore të avokatisë;
- c) brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe ia përcjell këtë listë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe dhomave vendore të avokatisë. Në hartimin e kësaj liste, Dhoma Kombëtare e Avokatisë mban parasysht, për aq sa është e mundur, përfshirjen e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore;

ç) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas;

dh) kryen detyra të tjera që i caktohen nga ky ligj.

### KREU III PËRFITUESIT E NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI

#### Neni 10

#### **Përfituesit e ndihmës juridike**

1. Subjekte përfituese të ndihmës juridike janë:

a) shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;

c) shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;

ç) azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

2. Subjektet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përfitojnë ndihmë juridike, nëse përmbushin kushtet e parashikuara nga ky ligj.

#### Neni 11

#### **Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike**

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

a) viktimave të dhunës në familje;

b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;

c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;

e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;

ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;

f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;

g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;

gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;

h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

## Neni 12

### **Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme**

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

2. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, sipas kuptimit të pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

4. Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, rregulli i parashikuar në pikën 2, të këtij neni, nuk do të zbatohet. Në këtë rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, sipas pikës 1, të këtij neni, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

## KREU IV

### NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE

## Neni 13

### **Dhënia e ndihmës juridike parësore**

Ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

## Neni 14

### **Dhënia e ndihmës juridike parësore nga punonjësit me trajnim të posaçëm**

Ndihma juridike parësore jepet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, nga punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar pranë këtyre qendrave.

## Neni 15

### **Dhënia e ndihmës juridike parësore nga organizatat jofitimprurëse**

1. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me

autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Organizatat jofitimprurëse që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore duhet të përmbushin këto kritere:

- a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
- b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike;
- c) të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi; ç) të kenë përvojë në ofrimin e ndihmës juridike;
- d) të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

dh) anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës dhe të organit ekzekutiv të organizatës jofitimprurëse të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe që do të cenonte besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike.

3. Organizatat jofitimprurëse të autorizuara për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 16

### **Dhënia e ndihmës juridike parësore nga klinikat ligjore**

1. Ndihma juridike parësore jepet nga klinikat ligjore të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë.
2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.

#### Neni 17

### **Kërkesa dhe procedura e dhënies së ndihmës juridike parësore**

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga personi i interesuar pranë një qendre shërbimi për ndihmë juridike parësore ose një organizate jofitimprurëse të autorizuar.

2. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmën juridike parësore, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të nënshkruajë një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kritereve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

3. Ndihma juridike parësore ofrohet menjëherë me marrjen e kërkesës. Në rast se dhënia e menjëhershme e ndihmës juridike parësore është e pamundur, personi informohet menjëherë për datën dhe kohën e dhënies së shërbimit të kërkuar.

4. Një person ka të drejtën të marrë shërbimet e ndihmës juridike parësore për të njëjtën problematikë ose çështje vetëm një herë, me përjashtim të rasteve kur rrethana të reja të caktuara justifikojnë dhënien e shërbimeve të mëtejshme të ndihmës juridike parësore për të njëjtin person, rreth së njëjtës problematikë ose çështje.

5. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet një konflikt interesi, ky shërbim ndërpritet menjëherë. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një qendër shërbimi për ndihmë juridike parësore, çështja trajtohet në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, për shmangien e konfliktit të interesit. Në rastin kur ndihma juridike parësore jepet nga një organizatë jofitimprurëse e autorizuar, kjo e fundit merr masa për shmangien e konfliktit të interesit, sipas dispozitave ligjore në fuqi, duke siguruar dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kërkuesin.

6. Në rast se gjatë dhënies së shërbimeve të ndihmës juridike parësore konstatohet se ekziston nevoja për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, personi informohet menjëherë për kushtet e dhënies së ndihmës juridike dytësore dhe ndihmohet për plotësimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore.

7. Gjatë ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore mbahet një procesverbal, i cili përmban:

a) emrin, mbiemrin dhe numrin e identifikimit personal të kërkuesit;

b) adresën e vendbanimit, të dhënat e kontaktit, gjendjen familjare, statusin e punësimit të kërkuesit;

c) një përshkrim të shkurtër të problematikës ose çështjes për të cilën janë kërkuar shërbimet e ndihmës juridike parësore;

ç) nëse është e mundur, kohëzgjatjen e takimit ose takimeve;

d) një përshkrim të shkurtër të dhënies së shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe rezultatin e këtij shërbimi;

dh) deklarimi se kërkuesi nuk ka përfituar më parë ndihmë juridike parësore për të njëjtën problematikë ose çështje;

e) të dhëna të tjera, sipas formularit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

8. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuesve të ndihmës juridike parësore bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## KREU V

### NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE

#### Neni 18

#### **Dhënia e ndihmës juridike dytësore**

Ndihma juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji. Kërkesa hartohet sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

#### Neni 19

#### **Kërkesa për ndihmë juridike dytësore**

1. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural.

2. Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën e

parashikuar në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë.

3. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore përjashtohet nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

4. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përfitimit, të përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Lista e dokumenteve që shërbejnë për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

#### Neni 20

### **Paraqitja e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe organi kompetent për shqyrtimin e saj**

1. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore e të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare paraqitet pranë organit procedues që fillon hetimet, sipas nenit 21 të këtij ligji.

#### Neni 21

### **Procedura e dhënies së ndihmës juridike dytësore të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare**

1. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare, organi procedues që fillon hetimet shqyrton menjëherë nëse përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

2. Nëse organi procedues që fillon hetimet vlerëson se kriteret janë përmbushur, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë personin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

3. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuesit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

4. Kërkuesi mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim.

5. Gjykata shqyrton çështjen me një gjyqtar, sipas rregullave të parashikuara në legjisllacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja dijani. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton rregullat dhe procedurat që ndiqen nga organi procedues që fillon hetimet, për caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës dhe zëvendësimin e tij nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal.

7. Rregulla të hollësishme që lidhen me garantimin e mbrojtjes së detyrueshme nga institucionet e parashikuara në këtë ligj, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, miratohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

#### Neni 22

### **Shqyrtimi i kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga gjykata**

1. Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmë juridike dytësore në përputhje me parashikimet në legjisllacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji.

2. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente:
- a) brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;
  - b) gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;
  - c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.
3. Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se korrigjimi ose plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të kërkuetit, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë. Në këto raste kërkesa për ndihmë juridike dytësore quhet e paraqitur në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata për paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga organet e administratës shtetërore.
4. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:
- a) pranimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore;
  - b) rrëzimin e kërkesës për dhënien e ndihmës juridike dytësore.
5. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore rrëzohet vetëm në rastet kur:
- a) nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenet 11 ose 12 të këtij ligji;
  - b) është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar.
6. Vendimi për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore jepet i arsyetuar.
7. Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Ankimi bëhet sipas formularit tip të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, i cili i jepet kërkuetit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës.
8. Gjykata e apelit shqyrton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.
9. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Në këtë rast zbatohen afatet dhe rregullat për ankimin e vendimeve përfundimtare, sipas dispozitave të legjislacionit procedural. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatë të Lartë.

#### Neni 23

### **Njoftimi i vendimit të gjykatës**

Vendimi i gjykatës mbi kërkesën për ndihmë juridike dytësore i njoftohet menjëherë:

- a) kërkuetit;
- b) personit që ka dorëzuar kërkesën për ndihmë juridike dytësore, në rast se është një person i ndryshëm nga kërkueti;
- c) organit procedues, nëse janë kushtet e nenit 21 të këtij ligji; ç) Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas;
- d) dhomës vendore të avokatisë, në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore është miratuar.

#### Neni 24



## **Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët**

1. Avokatët që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore plotësojnë këto kushte:
    - a) kanë aplikuar në Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe janë përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
    - b) kanë lidhur një kontratë vjetore shërbimi me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas;
    - c) janë caktuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore nga organi procedues ose dhoma vendore e avokatisë;
  - ç) janë të specializuar në fusha të së drejtës, kur specializimi është i nevojshëm, si në rastin e përfaqësimit të të miturve, të viktimave dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.
2. Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme:
    - a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit;
    - b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.
  3. Parashikimet e pikës 2, të këtij neni, nuk zbatohen në rastin kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore është paraqitur nga i pandehuri pa mjete të mjaftueshme financiare tek organi procedues që fillon hetimin.
  4. Avokati i caktuar, menjëherë pasi njihet me vendimin e gjykatës kompetente dhe vendimin e dhomës vendore të avokatisë ose me vendimin e organit procedues mbi caktimin e tij si avokat për dhënien e ndihmës juridike dytësore, hyn në marrëdhënie me personin, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe fillon dhënien e shërbimeve të kërkuara.
  5. Avokati i caktuar zëvendësohet nga një avokat tjetër, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, vetëm në rast se konstatohet një konflikt interesi midis avokatit dhe personit, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.
  6. Vendimi për zëvendësimin e avokatit të caktuar nga një avokat tjetër nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore merret nga:
    - a) organi procedues, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar nga ky organ;
    - b) dhoma vendore e avokatisë, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar prej saj.

### **KREU VI**

#### **PËRJASHTIMI NGA PAGIMI I TARIFAVE GJYQËSORE, SHPENZIMEVE GJYQËSORE DHE NGA DETYRIMI PËR PARAPAGIM TË TARIFAVE TË VËNIES NË EKZEKUTIM TË URDRIT TË EKZEKUTIMIT**

##### **Neni 25 Përfituesit**

Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

#### Neni 26

### **Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore**

1. Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës së miratuar nga Ministri i Drejtësisë.
2. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:
  - a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;
  - b) bashkëlidhur kërkesëpadsisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural;
  - c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.
3. Në kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të kërkohet përjashtimi nga pagimi i një, disa ose të gjitha tarifave gjyqësore dhe/ose i shpenzimeve gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji.
4. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet nga personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë.
5. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

#### Neni 27

### **Procedura e shqyrtimit të kërkesës**

1. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel.
2. Gjykata shqyrton kërkesën në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me parashikimet e nenit 22 të këtij ligji.
3. Gjykata, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe parashikimet në legjislacionin procedural, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:
  - a) pranimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;
  - b) rrëzimin e kërkesës për përjashtimin nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit, sipas parashikimeve të nenit 22 të këtij ligji.
4. Vendimi i pranimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore i njoftohet menjëherë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

#### Neni 28

## **Zbatimi i vendimit**

1. Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural.
2. Pagesa e shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Drejtësisë dhe paguhet nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.
3. Pagesat që kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, sipas pikës 2, të këtij neni, nuk mund të tejkalojnë masën e shpërblimit për ekspertët dhe dëshmitarët në një proces gjyqësor, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave.
4. Rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave, sipas pikës 2, të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë, pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për financat.

Neni 29

### **E drejta për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit**

Personat, të cilët kanë përfituar ndihmë juridike dytësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, gëzojnë të drejtën për të mos parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

## **KREU VII**

### **RIMBURSIMI**

Neni 30

#### **Detyrimet e palës gjyqumbëse në çështjet civile ose administrative**

1. Kur pala që është përjashtuar nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, fiton me vendim gjyqësor të formës së prerë çështjen, për të cilën është dhënë ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, pala tjetër gjyqumbëse, së cilës i ngarkohen pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, sipas vendimit gjyqësor, detyrohet të kalojë këtë shumë menjëherë për llogari të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.
2. Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, shërbimi përmbartimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 31

#### **Rastet e kthimit të përfitimeve**

1. Në rast se një person, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimin nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, i kanë ndryshuar rrethanat në një mënyrë të tillë që nuk plotëson kriteret ligjore për të qenë subjekt përfitues i ndihmës juridike dytësore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas i njofton përfituesit të ndihmës juridike detyrimin për kthimin vullnetar të shpenzimeve të kryera, shumën konkrete dhe afatin për përmbushjen e këtij detyrimi. Procedura, periodiciteti dhe rregullat e verifikimit të ndryshimit të rrethanave përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.
2. Në rast të mosekzekutimit vullnetar të detyrimit për kthimin e shpenzimeve brenda afatit të caktuar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Parashikimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, do të zbatohen dhe në rastin kur personi, të cilit i

është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore ose avokati i caktuar:

- a) nuk e ka paraqitur kërkesëpadinë në gjykatë, pas kalimit të një afati tremujor nga data kur vendimi i gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore ka marrë formë të prerë;
- b) ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, nga e drejta e padisë, nga ankimi dhe rekursi apo nga ekzekutimi i urdhrin të ekzekutimit.

#### Neni 32

### **Rimbursimi në rastin e dhënies së informacioneve të rreme ose të pavërteta**

1. Kërkuesi që ka përfituar ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, duke paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, është i detyruar të rimbursojë shpenzimet për avokatin që ka dhënë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe/ose shpenzimet gjyqësore. Pavarësisht nga rimbursimi i këtyre shpenzimeve, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bën kallëzim penal, kur konstaton se ka elemente të veprës penale.

2. Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, që përmban informacione të rreme ose të pavërteta, është dorëzuar nga një person tjetër i ndryshëm nga personi të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtimi nga tarifat gjyqësore dhe shpenzimet gjyqësore, dorëzuesi dhe përfituesi janë solidarisht përgjegjës për rimbursimin e shpenzimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Rimbursimi i shpenzimeve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij neni, bëhet sipas kërkesës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Në rast të mosekzekutimit vullnetar, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas paraqet kërkesëpadi në gjykatë, duke kërkuar kthimin e shumës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## KREU VIII

### DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

#### Neni 33

### **Buxheti**

1. Shpenzimet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në të gjitha format e saj, mbulohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme.

2. Fondet për ndihmën juridike të garantuar nga shteti përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.

#### Neni 34

### **Akte nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 15, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 28, pika 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, shkronjat “d”, “e”, “ë”, “f”, “gj” dhe “i”; nenit 17, pika 2; nenit 19, pika 4; nenit 28, pika 4, dhe nenit 31, pika 1, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja “b”, të këtij ligji.

4. Ngarkohet titullari i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që, brenda një muaji nga krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 9, shkronja “a”, të këtij ligji.

5. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për financat që, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të nenit 7, shkronja “g”, të këtij ligji.

6. Ngarkohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë që, brenda 3 muajve nga krijimi, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 21, pikat 6 dhe 7, të këtij ligji.

7. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji publikohen edhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe me anë të mjeteve të tjera të përshtatshme.

Neni 35

### **Publikime**

Formularët e paraqitjes së kërkesave dhe vetëdeklarimit, të parashikuara nga neni 7, shkronja “d”, i këtij ligji, publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

Neni 36

### **Dispozitë kalimtare**

1. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike pushon së ekzistuari me ngritjen e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

2. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ngrihet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore ngrihen brenda tre muajve nga krijimi i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas.

4. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike përfundon shqyrtimin e të gjithë kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike brenda datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”.

5. Kërkesat për ndihmë juridike dytësore, që janë paraqitur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që nuk janë shqyrtuar nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen sipas rregullave të parashikuara nga ky ligj.

6. Për nëpunësit civilë ekzistues të sekretariatit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

7. Punonjësit administrativë të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

8. Të gjitha të drejtat, detyrimet, qendrat ekzistuese të shërbimit të ndihmës juridike, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ dhe financiar i Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kalojnë dhe administrohen nga aparati i Ministrisë së Drejtësisë.

9. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë detyrat e parashikuara nga ky ligj për këtë organ kryhen nga Ministri i Drejtësisë.

10. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për sa kohë nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Neni 37

### **Shfuqizime**

Ligji nr. 10039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 38  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2018.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 14.12.2017